ARSIMI CILËSOR ËSHTË...

ARSIMI CILËSOR PËR NJË TË ARDHME MË TË NDRITUR

European Union Kosovo

EU INFORMATION AND CULTURAL CENTRE

PARATHËNIE

NGA AMBASADORJA NATALIYA APOSTOLOVA, SHEFE E ZYRËS SË BE-SË / PËRFAQËSUESE SPECIALE E BE-SË NË KOSOVË

SHKOLLIMI CILËSOR SHPIE NË NJË JETË MË CILËSORE, DHE NJË SHOQËRI MË PËRPARIMTARE

Të dashur student, nxënës, mësimdhënës, kolegë,

Fjala Evropë nënkupton kulturë dhe kultura qëndron në thelbin e Bashkimit Evropian. Pa e kuptuar plotësisht kulturën, ne, evropianët, rrezikojmë ta fshijmë historinë tonë të gjatë, të përbashkët e nganjëherë të vështirë. Ne rrezikojmë ta humbim identitetin tonë të pasuruar me llojllojshmëri gjuhësore, artistike e kreative, të cilat e bëjnë kontinentin tonë një vend unik. Edukimi është njëra prej pikave më të forta të kulturës evropiane. Duke qenë se Kosova është pjesë e familjes evropiane, trajtimi i edukimit si një prioritet strategjik është qenësor.

Edukimi është çelësi i suksesit dhe i përparimit. Vetëm një shoqëri e cila investon në edukim mund të ecë përpara. Qeveria, profesionistët në arsim, dhe shoqëria civile të gjithë duhet të punojnë për ta bërë prioritet të Kosovës edukimin cilësor. Arsimimi duhet t'i plotësojë nevojat e tregut.

Siç mund ta dini, Zyra e BE-së/Përfaqësuesja Speciale e BE-së dëshirojnë të shohin përmirësime thelbësore të arsimit në Kosovë. Në këtë drejtim, janë një numër detyrash që duhen kryer gjatë viteve në vazhdim. BE-ja është e vendosur që ta ndihmojë rininë e aftë kosovare që të jenë të përgatitur mirë për të hyrë në tregun e punës. BE-ja gjithashtu është e vendosur që të krijohen më shumë vende punë për popullatën e re. Ajo do të vazhdojë të ndërtojë shkolla moderne dhe të përgatisë materiale cilësore për mësim.

BE-ja do të ndihmojë përfshirjen më të madhe në arsim të të rinjve me kërkesa të veçanta dhe të nën-privilegjuarve, duke iu dhënë mundësinë që të ndjehen të barabartë në shoqërinë kosovare.

Duke pasur këtë parasysh, ajo që BE dëshiron të shohë në Kosovë gjatë viteve në vijim është: një rini të aftë në Kosovë, në gjendje të konkurrojë në tregun vendor dhe të BE-së; hendekun e zvogëluar në mes aftësive dhe nevojave të tregut; dhe një përfshirje më të madhe të komuniteteve joshumicë në shoqërinë kosovare.

Gjatë viteve në vijim, BE-ja synon ta dyfishojë mbështetjen e saj për arsimim të mirë, duke ndarë diku 35 milion euro për këtë qëllim.

Prandaj, ju, rinia në Kosovë, duhet të vështroni përpara jush jo vetëm cilësinë e arsimimit tuaj por edhe më shumë cilësinë e jetës suaj, e cila do ta bëjë Kosovën të përparuar, të suksesshme dhe paqësore.
Edukimi cilësor është një prej hapave të nevojshëm në këtë rrugëtim.

Ne, në BE, do të jemi me ju për t'ju ndihmuar sa më shumë që të mundemi.

PËRMBLEDHJE E MBËSHTETJES SË BE-SË PËR ARSIMIN NË KOSOVË

Investimi në arsim padyshim është investim në të ardhmen. Ai është thelbësor për punësimin dhe përparimin e përgjithshëm shoqëror. Arsimi cilësor dhe vitet e kaluara në të janë thelbësore për një forcë punëtore produktive, e cila kontribuon në rritjen ekonomike dhe zhvillimin kombëtar.

Kosova e ka numrin më të ulët në rajon kur bëhet fjalë për arsimin parashkollor dhe parafillor nga mosha 0-6 vjeç, gjë që shkaktohet nga mungesa e infrastrukturës dhe personelit.

Për më tepër, testi i standardizuar PISA e ka treguar se suksesi i nxënësve të Kosovës në nivel të shkollave të mesme është më i ulëti në rajon. Nxënësit e Kosovës u radhitën në tri vendet e fundit në matematikë, lexim dhe shkencë në PISA 2015. Mbetet ende të shihet nëse rezultatet e testit PISA për këtë vit janë përmirësuar pasi që mësuesit dhe nxënësit kanë shqyrtuar në hollësi fushat në të cilat kanë dështuar në testet e zhvilluara viteve të fundit dhe mund të jenë përgatitur për ta përmirësuar tërë procesin e mësimdhënies në Kosovë.

Kosova është aty nga fundi në rajon kur është fjala për punëtorët e kualifikuar, gjë që paraqet një ndër vështirësitë e shumta me të cilat përballen ndërmarrjet. Shkaku thelbësor për këtë është sistemi i dobët arsimor. Nevojiten reforma në të gjitha nivelet e sistemit arsimor në Kosovë. E tillë është edhe infrastruktura në këtë sektor.

BE-ja i ka mbështetur reformat arsimore të Kosovës përmes Instrumenti të Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA), zhvillimit të shkathtësive profesionale në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zgjerimit të mëtutjeshëm të skemave të bursave. Ndihma e ndarë nga BE-ja për periudhën 2014-2020 në Kosovë është 645.5 milionë euro.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka miratuar udhëzimin administrativ për masat dhe kuotat për regjistrimin e studentëve nga komunitetet pakicë në universitetet publike. Pas rrethit të parë të pranimeve, 96 studentë nga pakicat të cilët kanë përfunduar me sukses provimin pranues janë regjistruar në gjashtë universitete publike, numër ky më i lartë se në vitin e kaluar shkollor.

Bashkimi Evropian i ka synuar komunitetet e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve në lidhje me rritjen e gjasave të tyre për arsim. Në Prizren dhe Rahovec, projekti ia ka arritur që ta lëviz këtë komponentë/ndihmë në shkollat publike relevante ku ndihma nuk iu ofrohet vetëm komuniteteve të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve por edhe nxënësve të komunitetit shumicë duke kontribuar në integrimin ndëretnik.

BE-ja i ka dedikuar edhe 3,8 milionë euro shtesë me qëllim që të forcojë lidhjen në mes të sektorit të arsimit dhe nevojave të tregut të punës me theks të veçantë në Arsimin dhe Aftësimin Profesional.

Përmes projektit të binjakëzimit me Finlandën dhe Austrinë që e kap vlerën e 3 milionë eurove, BE-ja e ka mbështetur arsimin parauniversitar në fushat e zhvillimit të kurrikulës dhe mësimdhënësve, sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e nevojave për pajisje shkollore. Veç kësaj, BE-ja ka siguruar pajisje, projektorë, laptopë, pajisje të përgjithshme dhe sportive për mbi 100 shkolla anekënd Kosovës.

Përmes projekteve të ndryshme, BE-ja ka ndihmuar në ndërtimin apo rindërtimin e hapësirave me rëndësi edukative si bibliotekat, arkivat dhe ndërtesat e shkollave. Për shembull, në Lipjan Ndërtesës së Bibliotekës dhe Arkivit i janë ndarë 740.000 euro për të krijuar një ndërtesë të re trekatëshe me hapësirë prej 1500 m2 me një klasë të madhe për studim në grup dhe për lexim.

Përmes projektit të Përputhjes së Arsimit me nevojat e Tregut të Punës në vlerë prej 2.8 milionë eurosh, BE-ja ka ndihmuar në përmirësimin e cilësisë dhe rëndësisë së programeve arsimore.

BE-ja po ashtu ka financuar edhe Rrjetin e Arsimit të Kosovës (KEEN) për promovimin e përfshirjes së grupeve të ndjeshme në tregun e punës dhe sistemin arsimor në Kosovë.

Me një investim të përgjithshëm prej 17 milionë eurosh, BE-ja ka mbështetur zbatimin e masave efikase energjetike në 63 shkolla ekzistuese nëpër komuna të ndryshme të Kosovës dhe 2 spitale në Prishtinë. Masat për Energjinë Efiçiente, me qëllim të promovimit të shfrytëzimit më të arsyeshëm të energjisë janë përqendruar në: përmirësimin e ndërtesave (si izolimi i jashtëm termal i ndërtesave, zëvendësimi i dritareve dhe dyerve të jashtme, izolimi termal dhe nga uji i kulmeve, etj.); sistemet e ngrohjes, rrymës dhe ndriçimit, sistemet për kontrollimin e ventilimit dhe futja e burimeve të ripërtërishme të energjisë si panelet solare për ngrohjen e ujit

Falë investimeve të BE-së shumë shkolla anekënd Kosovës tani kanë qasje në Teknologjinë Informative e të Komunikimit dhe mësimit elektronik.

BE-ja po ashtu i ka përkrahur edhe institucionet private të arsimit të lartë si Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM). Arsimi i lartë në Kosovë mbështetet edhe nga programet Erasmus+, Young Cell Scheme dhe Horizon 2020.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit e nënshkruar në mes të Kosovës dhe BE-së në vitin 2015 parasheh bashkëpunimin e ndërsjellë në mënyrë që të ngrihet niveli i arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe aftësimeve profesionale. Prioritet për arsimin e lartë është arritja e standardeve në përputhje me procesin e Bolonjës.

Pas nënshkrimit të MSA-së, arsimi u bë një nga prioritetet e BE-së në dialogun për politikat me Kosovën. Ai është në krye të Agjendës Evropiane për Reformë dhe Programin e Reformave Politike si mjete për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Sidoqoftë, raportet e Komisionit Evropian për Kosovën vazhdimisht e kanë cekur se nuk është shënuar përparim në përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Kosova e ka GDP-në më të ulët në Evropë, me një popullsi shumë të re: 50% e popullatës së saj janë nën moshën 25 vjeçare. Shkalla e papunësisë është 30% dhe është më e theksuar në mesin e të rinjve. Sipas Anketës së Forcës Punëtore që është zhvilluar në çerekun e dytë të vitit 2017, 51% e njerëzve në moshën 15-24 vjeçare të forcës punëtore ishin të papunë. Mbi 27% e popullsisë së kësaj moshe nuk e vijonin shkollën, nuk ishin të punësuar dhe nuk vijonin trajnime. Papunësia është më e lartë në mesin e femrave (60%).

Krahas kësaj, përderisa 70% e femrave në Kosovë kanë mbaruar shkollimin bazë apo nuk kanë shkollim fare; 38% e meshkujve e kanë nivelin e ngjashëm të arsimit.

Papunësia e femrave dhe nivelet e ulëta të pjesëmarrjes së tyre janë po ashtu brengosëse. Pjesëmarrja e femrave në tregun e punës është 18%, përderisa nivelet ë punësimit të femrave janë rreth 11,5%. Një tjetër aspekt problematik është se mbi 70% e të papunësuarve janë të papunë afatgjatë.

Në anën tjetër, diploma universitare jo doemos është garanci për punësim. Rreth 25% e njerëzve me arsim universitar janë të papunë, sipas studimit të njëjtë të kryer nga Anketa e Forcës Punëtore. Kjo përqindje rritet me uljen e nivelit të arsimit, do të thotë, papunësia në mesin e njerëzve që e kanë mbaruar shkollën e mesme është 28,3% përderisa shkalla e papunësisë në mesin e njerëzve me arsim të mesëm profesional është 33,5%. Tregtia, prodhimtaria, ndërtimtaria dhe arsimi vazhdojnë të punësojnë pothuajse gjysmën e njerëzve të punësuar.

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2016 thekson se shpenzimet e Kosovës për nxënës në arsimin fillor dhe të mesëm janë dukshëm më të ulëta se në vendet e rajonit - gjatë vitit 2015, shpenzimi publik në arsim ishte 3,9% e GDP-së. Për më tepër, 75% e të gjitha shpenzimeve shkojnë për rrogat dhe rritjet në shpenzimet në arsim përdoren pothuajse tërësisht për rritjen e rrogave në vend të përmirësimit të cilësisë së arsimit (vetëm 0,2% e shpenzimeve në arsim janë caktuar për trajnimin e mësimdhënësve). Shkalla e vijueshmërisë në arsimin parashkollor dhe parafillor është ende shumë e ulët (3,7%, respektivisht 74%) gjë që i pengon përpjekjet për të krijuar një nivel të barabartë për fillimin e shkollës fillore.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 e parasheh përmirësimin e planifikimit të shpenzimeve në sistemin arsimor por duhet punuar më shumë në përfshirjen më të lartë të fëmijëve në institucionet parashkollore. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në shkollat fillore dhe të mesme dhe ndërlidhja më e mirë në mes të shkathtësive të marra në arsim dhe nevojave të tregut të punës nevojiten për të arritur sukses në nivele më të larta të arsimit.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka hartuar edhe dy plane strategjike gjithëpërfshirëse për zhvillimin e arsimit në Kosovë për periudhën 2011-2016 dhe 2017-2021. Qëllimi i tyre është që të përmirësojnë cilësinë e arsimit dhe përfshirjen por edhe të sigurohet llogaridhënia për suksesin e nxënësve.

Disa përmirësime të dukshme janë vërejtur në procesin e hartimit të politikave në arsimin parashkollor, megjithatë nuk është regjistruar ndonjë rritje domethënëse në regjistrimin e fëmijëve parashkollor. Është arritur nivel i lartë i regjistrimit në arsimin parauniversitar dhe arritjet e nxënësve në provimet e jashtme kanë shënuar rritje modeste, por kjo do të mbetet një sfidë për sistemin arsimor. Ndonëse rreth gjysma e nxënëse në shkollimin e lartë të mesëm kanë zgjedhur arsimin profesional, lidhja e mësimit profesional me tregun e punës po ashtu mbetet një sfidë. Qasja në teknologjinë informative dhe të komunikimit (TIK) ende nuk është integruar si duhet në kurrikulë.

Adresimi i sektorëve kyçë të arsimit dhe punësimit është thelbësor për zhvillimin e politikave konkurruese në Kosovë. Këta sektorë janë të ndërlidhur ngushtë dhe çdo veprim që do të implementohet në sektorin e punësimit duhet të ketë parasysh zhvillimet në arsim dhe/ose në sektorin e konkurrencës.[1]

1. HTTPS://EC.EUROPA.EU/NEIGHBOURHOOD-ENLARGEMENT/SITES/NEAR/FILES/IPA_2017_040505.10_KS_EU_SUPPORT_FOR_ALIGNING_EDUCATION_AND_TRAINING_WITH_LABOUR_MARKET.PDF

MBËSHTETJA E BE-SË PËR SISTEMIN ARSIMOR PARASHKOLLOR

TË MËSUARIT FILLON ME TË LINDUR

Arsimi në fëmijërinë e hershme luan rol të rëndësishëm për performancën më të mirë të fëmijëve më vonë, posaçërisht për fëmijët që vijnë nga mjedise të pa favorizuara. Në Kosovë, regjistrimi i fëmijëve nga mosha 0-6 në programet arsimore është shumë më i ulët se sa në rajon.

Sistemi i arsimit publik në Kosovë e ka një rrjet me 43 institucione parashkollore. Mungesa e infrastrukturës fizike dhe personelit janë disa prej arsyeve që e shkaktojnë pjesëmarrjen e ulët të fëmijëve në aktivitetet parashkollore. BE-ja e ka mbështetur arsimin parashkollor me qëllim që të shtojë përfshirjen e fëmijëve në Kosovë në arsimin parashkollor.

Me një buxhet prej 5 milionë eurosh BE-ja e ka mbështetur ndërtimin e 5-6 kopshteve për fëmijë në mbarë Kosovën dhe përgatitjen e skicave të detajuara duke përfshirë edhe mbikëqyrjen gjatë ndërtimit. Veç kësaj sipas IPA 2014, ndërtimi i një kopshti të ri për fëmijë në Prishtinë (Kalabri) është paraparë të fillojë në shtator të vitit 2018. Përgatitja e dizajnit të detajuar është në vazhdim e sipër dhe financohet nga BE-ja.

Që nga viti 2016, Ferizaj e ka një ndërtesë të re të kopshtit për fëmijë me 1983 m2, me rreth 190 fëmijë. Kjo ishte pjesë e programit të BE-së për infrastrukturë komunale, sociale dhe ekonomike, i cili e mbështet zhvillimin e balancuar rajonal në Kosovë. Kopshti publik për fëmijë "Ardhmëria jonë" tani i ka dy kate dhe përfshinë edhe dhomat e fëmijëve, tualetet, kuzhinën, administratën, dhomën e edukatorit, dhomat e mirëmbajtjes dhe magazinimit, si dhe lavanderinë. Udhëheqësja e kopshtit, Zuhal Avdullahu, thotë se kushtet në ndërtesën e mëparshme e cila ishte ndërtuar në vitin 1960 ishin të mjerueshme dhe ndërtesa e re ishte më se e nevojshme.

Sidoqoftë, ajo shpreson se më shumë fëmijë do të regjistrohen në këtë institucion. "Ka hapësirë për më shumë dhe unë pres më shumë fëmijë. Sidoqoftë, shumë prej tyre janë regjistruar në institucione private. Unë e kam hapur derën për të gjithë fëmijët dhe asnjë prej tyre nuk do të refuzohet. Ndërtesa jonë e re tashmë ofron gjithçka që ne kemi nevojë," tha ajo.

BE-ja po ashtu thekson se qasja në arsim cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe komunitetet pakicë duhet të përmirësohet. Ndërtimet e kopshteve janë bërë edhe përmes projekteve të tjera të ndryshme të BE-së.

Në vitin 2016, një kopsht i ri me një sipërfaqe prej 600m2 me oborr dhe shesh të lojërave është hapur në lagjen Arbëria në Prishtinë. Një tjetër kopsht me vlerë pothuajse 1 milion euro është hapur në Leshak, Komuna e Leposaviqit. Mbështetja në këtë sektor është thelbësore për shkak të nivelit të ulët të regjistrimit i cili mbetet një shqetësim, posaçërisht për fëmijët e moshës 0-4 vjeçare, pjesëmarrja e të cilëve në institucionet parashkollore është vetëm 2,8%. Kjo përqindje rritet në 29,6% për moshat nga 3-5 vjeçare, përderisa pjesëmarrja në arsimin parafillor është rreth 80%.

Sipas IPA 2017, planifikohet shpenzimi i 7,2 milionë eurove për përgatitjen e dizajnit të detajuar, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e 3-4 shkollave. Fondet e BE-së do të përdoren për të mbikëqyrur, ndërtuar, furnizuar tri shkollat që do të ndërtohen. Këto shkolla do të ofrojnë arsim fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1-9). BE ka caktuar për qëllim që deri në vitin 2020 të paktën 95% e fëmijëve parashkollorë duke filluar nga mosha 4 vjeçare e tutje duhet të marrin pjesë në arsimin parashkollor. PSAK (Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016) synonte që deri në vitin 2016, të gjithë fëmijët e moshës 5 vjeçare të përfshihen në arsimin parafillor, dhe rreth 50% e fëmijëve të moshës 0-5 vjeçare duhet t përfshihen në këtë nivel të arsimit. Plani po ashtu parashihte një sistem funksional për trajnimin e edukatorëve dhe kurrikulën e re. Ndonëse kishte disa rezultate në kurrikulën e arsimit parafillor dhe trajnimet e edukatorëve, nuk ka pasur progres në rritjen e përfshirjes në arsimin parafillor për fëmijët e moshës 0-4 vjeçare. Është arritur regjistrim më i lartë i fëmijëve të moshës 5 vjeçare.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 e Kosovës synon që të arrijë përfshirjen universale në arsimin parafillor dhe rritjen e numrit të fëmijëve që e vijojnë arsimin parashkollor me nga 5.000 fëmijë çdo vit deri në vitin 2021. Kjo planifikohet që të bëhet përmes rritjes se numrit të kopshteve publike për fëmijë dhe përmes rritjes së përfshirjes përmes institucioneve private. Në bazë të propozimeve të komunave, do të ndërtohen 18 kopshte parafillore. Ndihma financiare e BE-së në alokime të ndryshme po ashtu i ka ndihmuar komunitetet e ndryshme në ndërtimin e kapaciteteve dhe përfshirjen në sistemin e arsimit bazë.

BE-ja, në bashkëpunim me Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOC), Qendrën për Arsim të Kosovës (QAK), Balkan Sunflowers (BSF), Bethany Christian Services (BCS), Nevo Koncepti (NVK), SHL Kosova (SHL-K), Syri i Vizionit (SiV) dhe Qendrën Dokumentuese të Romëve dhe Ashkalinjëve (QDRA) u bashkuan për të ndihmuar komunitetet e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve në Kosovë në aspekte të ndryshme arsimore. Duke filluar nga viti 2016 dhe deri në mars të vitit 2019 më shumë se 1 milion euro do të shpenzohen për të siguruar qasje të barabartë për fëmijët romë, ashkalinjë dhe egjiptianë në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm duke përmirësuar regjistrimin, qëndrimin dhe arritjet e fëmijëve përmes mbështetjes të bazuar në komunitet dhe asaj financiare. Projekti deri tani e ka përfunduar vitin e parë të bursave për 67 studentë romë, ashkalinjë dhe egjiptianë krahas 130 bursave të ndara nga Ministria e Arsimit. Viti i dytë i bursave është në fazën finale të përfundimit.

Për më tepër, në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja: "Zbatimi i Masave për Efiçiencë Energjetike në Shkollat dhe Spitalet e Kosovës", ku 63 shkolla ekzistuese janë ndihmuar në masat e efiçiencës energjetike, një objektiv shtesë i këtij projekti ishte matja dhe monitorimi, përgjatë një periudhe një vjeçare, të zbatuar nga MEE-ja në ndërtesat e shkollave. Përllogaritjet e auditimit energjetik në 53 shkolla kanë treguar se ka përfitime të prekshme si në aspektin mjedisor edhe atë natyror, si për shembull kursim vjetor energjetik domethënës me një mesatare prej 62%, zvogëlimin e emetimit të CO2 prej 60%, e tërë kjo është arritur me Periudhën e Shpagimit (PShE) për MEE prej 7,26 vitesh.

Më parë këto shkolla ishin konsumues të mëdhenj të energjisë dhe u mungonin kushtet elementare për rehati. MEE-të që janë zbatuar e kanë përmirësuar dukshëm shëndetin, rehatinë dhe produktivitetin e mjedisit mësimor të shkollave si dhe cilësinë ajrit brenda spitaleve. Zvogëlimi i konsumit të energjisë dhe përdorimit të derivateve fosile në këto ndërtesa do të mbështesin drejtpërsëdrejti Kosovën në zbatimin e strategjisë gjithëpërfshirëse energjetike dhe rritjen e politikave për energji të ripërtërishme. Zbatimi i masave të identifikuara do të ndihmojë qeverinë e Kosovës që të përmbushë synimin e kursimit prej 9% të kursimeve të energjisë deri në vitin 2018.

Duke ndihmuar Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në procesin e reformës arsimore, projekti "Zhvillimi i Kapaciteteve në Arsimin Bazë (ZhKAB) në Kosovë" synon që të përmirësojë cilësinë e arsimit në Kosovë. Ai mbështet Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT), për të nxitur procesin e reformave arsimore përmes përfshirjes së palëve të ndryshme të interesit në nivelin kombëtar, komunal dhe lokal. Synohet që institucionet zyrtare, mësimdhënësit, prindërit, fëmijët dhe shoqëria civile të kontribuojnë në mënyrë aktive në cilësinë e arsimit. Mbi 3.000 fëmijë kanë marrë pjesë në aktivitete arsimore ekstra-kurrikulare siç janë mentorimi, ndihma në detyrat e shtëpisë, aktivitetet ndërkulturore të dizajnuara në mënyrë të qartë për t'i mbështetur fëmijët që kthehen nga migrimi dhe ata të pakicave etnike.

Gjatë gjithë këtij projekti që ka filluar në vitin 2015 dhe i cili do të vazhdojë deri në vitin tjetër, mbi 2.000 fëmijë kanë përfituar nga programet verore edukative që kanë zgjatur ndërmjet 2 dhe 5 javëve, si dhe nga akademia verore me punëtori të ndryshme kreative. Përveç Prishtinës, nga ky projekt kanë përfituar edhe qytete të tjera si Mitrovica, Gjakova, Podujeva, Ferizaj, Peja, Graçanica, Gjilani, Fushë Kosova dhe Obiliqi. Mbi 500 fëmijë kanë përfituar nga shfaqja e filmave pedagogjikë dhe diskutimet e hapura për përfshirjen arsimore, mundësitë e barabarta dhe kohezionin shoqëror. Mbi 2.000 prindër dhe anëtarë të tjerë të familjes nga pakicat etnike kanë marrë pjesë në aktivitetet e ngritjes së vetëdijes për arsimimin dhe mirëqenien e fëmijëve të tyre.

MBËSHTETJA E BE-SË PËR SISTEMIN E ARSIMIT TË MESËM/KURRIKULËN E RE

SFIDA E KURRIKULËS SË RE

Ndonëse niveli i përfshirjes në arsimin parauniversitar në Kosovë mund të krahasohet me praktikat evropiane, arritjet e pakënaqshme të nxënësve në testet e jashtme mbeten sfidë. Mekanizmat për sigurimin e cilësisë dhe llogaridhënies mbesin të pazhvilluara. Rezultatet e Programit të Vlerësimit Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) të publikuara në vitin 2016 tregojnë se nga 72 vende pjesëmarrëse, Kosova radhitet në grupin e tri vendeve me performancën më të ulët. Këto rezultate e tregojnë performancën e nxënësve që i vijojnë shkollat e mesme anekënd Kosovës.

Sivjet, më 12 prill dhe më pas më 16 dhe 17 prill, nxënësit e moshës 12 vjeçare iu nënshtruan sërish testit në kryeqytetin e Kosovës në Prishtinë. Ata i testuan njohuritë e tyre në matematikë, shkencë dhe lexim. Kësaj here testi është zhvilluar përmes kompjuterëve dhe jo me dorë. Testi po ashtu u realizua edhe në Prizren dhe në komunat e tjera. Raundi i parë i testimit do të përfundojë më 26 prill kurse rezultatet e Programit të Vlerësimit Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) për vitin 2018 do të publikohen në dhjetor të vitit 2019.

Për BE-në rezultatet e publikuara në vitin 2016 ishin shqetësuese prandaj BE-ja bëri thirrje për reforma dhe më shumë transparencë dhe llogaridhënie në të gjitha nivelet. Tekstet e reja shkollore, trajnimet e mësimdhënësve, zbatimi i kurrikulës së re ishin disa prej kështillave të BE-së dhe donatorëve të tjerë për Kosovën. Shumë shqetësime janë ngritur dhe është debatuar shumë për tekstet e ndryshme shkollore dhe vlerat e tyre profesionale. Shumë tekste shkollore janë të vjetra dhe kryesisht janë publikuar përpara viteve të 90-ta dhe të 80-ta dhe nuk janë përditësuar me faktet më të reja, përderisa tekstet e ndryshme shkollore të niveleve të ndryshme të arsimit në Kosovë përmbajnë shënime homofobike, ksenofobike dhe raciste. Vitin e kaluar, një skandal[2] shpërtheu pasi që në librat e biologjisë njerëzit me Sindromën Down përshkruheshin si "idiotia mongoloide" – një term përbuzës në këtë aspekt. BE-ja dhe donatorët i kanë këshilluar akterët e ndryshëm dhe palët e interesuara që ta ndërrojnë këtë praktikë dhe të përshtaten me njohuritë më të përditësuara dhe profesionale.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) e Kosovës në vitin 2011 e kanë inicuar Kornizën e Kurrikulës për arsimin parauniversitar. Me të është prezantuar ndryshimi i ligjërimit nga ai me mësuesin në qendër tek ai me nxënësin në qendër, përmes metodave moderne të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke u bazuar në rezultatet dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve. Qëllimi ishte që të përgatiteshin të rinjtë që të përballen me sfidat e shekullit të 21-ë, për të gjeneruar njohuri të reja konkurruese për tregun global të punës dhe për të rregulluar sistemin arsimor parauniversitar. Ky ndërrim nga kurrikula e përqendruar në përmbajtje tek ajo e bazuar në kompetencë është thelbësore për arritje më të mira të nxënësve. Përveç shtatë fushave të nxënies - gjuhët dhe komunikimi, matematika, shkencat, shoqëria dhe mjedisi, shëndeti dhe mirëqenia, jeta dhe mjedisi, shkathtësitë kyçe përfshijnë edhe komunikimin dhe shprehjen, të menduarit, të mësuarit, të jetuarit, të punës dhe shkathtësive të tjera personale dhe qytetare. Këto reforma kërkojnë më shumë materiale mësimore, trajnime për mësimdhënësit dhe vlerësime të reja.

Aktualisht, vetëm rreth 10% e shkollave në Kosovë janë duke e zbatuar kurrikulën e re dhe vetëm 30% e mësimdhënësve janë të trajnuar për këtë. Zbatimi i ngadalshëm është për shkak të numrit të vogël të trajnerëve dhe kualifikimeve të tyre të pamjaftueshme për të trajnuar.

---

2. HTTPS://TELEGRAFI.COM/SKANDALOZE-NE-LIBRAT-E-BIOLOGJISE-NE-KOSOVE-PERSONI-SINDROMEN-CILESOHET-IDIOT-MONGOLOID-QE-NUK-JETON-SHUME-SE-15-VITE/

Nga viti 2014 deri në vitin 2016 projekti i BE-së i binjakëzimit me Finlandën dhe Austrinë, në vlerë prej 3 milionë eurosh, e ka mbështetur Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në zbatimin e Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës (PSAK) 2011-2016.

Binjakëzimi është instrument evropian për bashkëpunim në mes të administratave publike të shteteve të BE-së dhe të shteteve përfituese. Projektet e binjakëzimit bashkojnë ekspertizën e sektorit publik nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe shtetet përfituese me qëllim që të arrihen rezultate konkrete të detyrueshme operacionale nëpërmjet aktiviteteve në mes kolegëve.

Qëllimet e tij kryesore ishin zbatimi i kurrikulës së re, zhvillimi i mësuesve dhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve në përputhje me kurrikulën e re, sistemin e sigurimit të cilësisë dhe furnizimeve bazike që nevojiten për kurrikulën e re.

Në kuadër të projektit janë përgatitur mjetet e tilla si udhërrëfyesi për zbatimin e kurrikulës së re dhe përfshirjes në arsim, dhe udhërrëfyesi për TIK në mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe strategjia e vlerësimit të cilësisë.

Si rezultat i kësaj, të gjitha shkollat në Kosovë janë informuar dhe udhëzuar rreth kurrikulës së re; syllabusët përkatës janë përgatitur dhe Ministria është përkrahur në planifikimin dhe organizimin e programeve për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Në përgjithësi 2.200 mësimdhënës janë trajnuar në pesë fusha: Gjuhë dhe Komunikim, Matematikë, Shkenca Natyrore, Shoqëri dhe Mjedis, Edukatë Fizike, Shëndetësi dhe Mirëqenie.

Gjithashtu, një sistem koherent për sigurimin e cilësisë është përgatitur dhe është bërë vlerësimi i nevojave për të përgatitur një raport të mjeteve dhe pajisjeve për të cilat kanë nevojë shkollat në Kosovë në lidhje me kërkesat e kurrikulës së re.

Projekti binjakëzues e ka mbështetur nismën e Ministrisë për të zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse për të siguruar cilësinë në mënyrë që të kontribuohet në përmirësimin e shërbimeve arsimore.

Analiza ka treguar se pikat e dobëta të sigurimit të cilësisë në Kosovë janë ndarja e përgjegjësive në mes të tri niveleve të institucioneve arsimore - Ministria, komunat, shkollat - kapacitetet e tyre për të menaxhuar detyra, qasja jo sistematike ndaj procesit të zhvillimit të planifikimit në shkolla dhe në nivel komunal, por edhe vetëdija e ulët rreth problemit të cilësisë në arsim në Kosovë.

Ndonëse BE-ja ka investuar shumë në këtë projekt, Kosova do të ketë nevojë për mbështetje në zbatimin e mëtutjeshëm të kurrikulës së re, deri në vlerësimin përfundimtar kombëtar në pranverë të vitit 2021.

Sidoqoftë, nevojiten trajnime më efektive për mësimdhënësit për kurrikulën e re. Ekzistojnë rreth 23.000 mësimdhënës të cilët duhet të trajnohen për kurrikulën e re në 1.200 shkolla parauniversitare në tërë Kosovën. Duke qenë se implementimi i kurrikulës së re në nivel kombëtare do të jetë një sfidë, po ashtu ka nevojë për përkrahje dhe vetëdijesim.

FLETË FAKTESH: PËRKRAHJA E BE-SË PËR ARSIM

- Arsimi ka qenë dhe vazhdon të jetë prioritet i BE-së për përkrahjen për Kosovën. Investimi në arsim është investim në të ardhmen dhe është me rëndësi kritike për vendet e punës dhe përparimin e përgjithshëm të shoqërisë. Arsimi cilësor dhe vitet e kaluara në arsimim janë thelbësore për një fuqi punëtore produktive, e cila kontribuon në rritjen ekonomike dhe zhvillimin.

- BE e përkrah Kosovën në përmirësimin e cilësisë së arsimit. Nga planifikimi strategjik, infrastruktura, teknologjia, trajnimi i mësimdhënësve dhe administrata, bursat në universitetet evropiane dhe pjesëmarrja në programe të avancuara.

- Nga fondet e IPA-s të vitit 2014, Bashkimi Evropian ka pasur në cak komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë në drejtim të rritjes së perspektivave të tyre për arsim.

- Nga viti 2007 deri në vitin 2013 BE-ja e ka përkrahur sektorin e arsimit me rreth 35 milionë euro. Vlerësimi i përgjithshëm i Fondit IPA për periudhën 2014-2020 në Kosovë është 645.5 milionë euro. Nga fondet e IPA-s të vitit 2017, 3.8 milionë euro shtesë janë ndarë për ta forcuar lidhjen ndërmjet sektorit të arsimit dhe nevojave të tregut të punës, duke u përqendruar në Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP).

- Përmes projektit të binjakëzimit me Finlandën dhe Austrinë me vlerë prej 3 milion euro, BE-ja ka përkrahur arsimin parauniversitar në fushat e kurrikulës dhe zhvillimit të mësimdhënësve, sigurimit të cilësisë dhe nevojave për vlerësim të furnizimeve shkollore. Përveç kësaj vlere, BE-ja ka ofruar pajisje, projektorë të të dhënave, laptopë, pajisje të përgjithshme dhe sportive në mbi 100 shkolla në mbarë Kosovën.

- Përmes Projektit të Përshtatjes së Arsimit me Nevojat e Tregut të Punës (ALLED) me vlerë 2.8 milionë euro, BE ka ndihmuar në përmirësimin e cilësisë dhe relevancës së programeve të arsimit.

- Shkolla të shumta në mbarë Kosovën tani kanë qasje në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit dhe në e-Learning (mësim elektronik), falë investimeve të BE-së.

- BE ka caktuar për qëllim që deri në vitin 2020 të paktën 95% e fëmijëve parashkollorë prej 4 vjet ose më të mëdhenj duhet të marrin pjesë në arsimin parashkollor.

- Mbi 2.000 fëmijë, nga qytete të ndryshme të Kosovës, kanë përfituar nga programet arsimore verore.

- BE-ja ka përkrahur një aksion të MASHT-it, të quajtur "TIK dhe e-mësimi në arsim", me investimin e përgjithshëm të BE-së në këtë fushë në shumë prej 4.5 milion €. Me fonde shtesë të BE-së, 134 shkolla kanë marrë pajisje të TIK, nga të cilat 75 ishin shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, 29 gjimnaze, 25 shkolla profesionale dhe 5 qendra burimore.

- Për ta përmirësuar arsimin e lartë në Kosovë, BE-ja ka ndihmuar me: ndër-kulturalizmin dhe projektin e procesit të Bolonjës me vlerë 1.4 milion euro. Përmirësimi i menaxhimit dhe cilësisë së sistemit të arsimit të përgjithshëm përmes qasjes në mbarë sektorin në projektin e arsimit me vlerë 3 milion euro.

- BE-ja ka përkrahur me 1.6 milion euro Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit të Mitrovicës (IBCM), një kolegj multi-etnik i hapur në vitin 2010. Përveç kësaj, BE do t'i financojë edhe aktivitetet e IBCM-së për vitin akademik 2017-2018.

- BE po përkrah arsimin e lartë në Kosovë edhe përmes Skemës së të Rinjve TEMPUS, Programeve ERASMUS MUNDUS dhe Horizont 2020.

- BE e ka përkrahur aktivisht arsimin në Kosovë në bashkëpunim të afërt me donatorët e tjerë: (USAID, GIZ, Banka Botërore, UNICEF, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), LuxDev, Ambasada Gjermane, Bashkëpunimi Zviceran, SIDA) dhe po përqendrohet shumë në vendosjen e proceseve të bazuara në merita në të gjitha nivelet në arsim dhe prandaj edhe në promovimin e përsosmërisë që do ta përshkojë tërë sistemin.

MBËSHTETJA PËR TIK DHE TË MËSUARIT ELEKTRONIK

NË HAP ME TEKNOLOGJINË

Integrimi i Teknologjisë Informative dhe të komunikimit (TIK) në mësimnxënie dhe mësimdhënie është i pashmangshëm për të ardhmen e nxënësve nëse shkollat duan ta ruajnë vëmendjen e nxënësve. Ndonëse Kosova është një vend me një shkallë të lartë të përdorimit të TIK-ut - vlerësohet se 76,6% e popullsisë së Kosovës e përdorin internetin - shkollat e Kosovës e kanë nga një kompjuter për 46 nxënës. Në BE një kompjuter shërben mesatarisht për 3-7 nxënës.

BE-ja e ka mbështetur mësimin elektronik në Kosovë me një projekt përmes të cilit rreth 57 shkolla janë pajisur me infrastrukturën e TIK-ut ne vlerë prej 25.000 eurosh për shkollë. Shkollat me nxënës nga pakicat etnike dhe nxënës me nevoja të veçanta po ashtu kanë përfituar nga ky projekt.

Qendra burimore "Përparimi" në Prishtinë, e cila ofron shërbime edukative për rreth 113 nxënës me nevoja të veçanta ishte një prej shkollave që ka pranuar mbështetje me infrastrukturë të TIK-ut si video projektorë, laptopë, iPad-ë, dhe televizorë.

Igballe Potera, drejtoresha e qendrës 'Përparimi', është shprehur falënderuese për infrastrukturën që BE-ja ia ka dhuruar kësaj qendre, e cila është unike dhe e ka një mision shumë të ndjeshëm në përgjithësi.

"Këto pajisje e kanë ndihmuar jashtëzakonisht shumë procesin tonë të mësimdhënies. Në këto lloje të shkollave ne gjithmonë duhet ta ndryshojmë ose përshtatim sistemin tonë të të mësuarit sipas aftësive të nxënësve tanë. Kjo teknologji na ofron shumë mundësi që të dalim mirë në punën tonë. Mësimdhënësit tanë janë shumë të kënaqur me këtë investim dhe puna e tyre është lehtësuar shumë. Për më tepër, është edhe një ngritje morale për prindërit pasi që ata e shohin se edhe të tjerët po mendojnë për fëmijët e tyre," theksoi drejtoresha e qendrës 'Përparimi' - Igballe Potera.

Projekti po ashtu e ka përfshirë edhe trajnimin e mësimdhënësve dhe nxënësve se si ta përdorin materialin elektronik për të ligjëruar dhe mësuar.

Përveç kësaj, BE-ja ka përkrahur një aksion të MASHT-it, të quajtur "TIK dhe mësimi elektronik në arsim" (Teknologjia Informative dhe Komunikuese) me investimin e përgjithshëm të BE-së në këtë fushë në shumë prej 4,5 milion eurosh.

Një udhërrëfyes për TIK-un është hartuar në bashkëpunim me MASHT-in në mënyrë që të mbështetet mësimdhënia dhe mësimnxënia. Me fonde shtesë të BE-së, 134 shkolla kanë marrë pajisje të TIK, nga të cilat 75 ishin shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, 29 gjimnaze, 25 shkolla profesionale dhe 5 qendra burimore. Kjo filloi në vitin 2015 dhe përfundoi në vitin 2017. Në këto shkolla u zhvilluan edhe trajnime për mësimdhënës dhe trajnime për drejtorë të shkollave si dhe për përfaqësues të ministrisë dhe komunave.

MBËSHTETJA PËR ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL

PËRPUTHJA E SHKATHTËSIVE ME NEVOJAT E TREGUT TË PUNËS

Rreth gjysma e nxënësve të arsimit të mesëm në Kosovë i vijojnë shkollat profesionale, ndonëse ato nuk janë në përputhje me nevojat e tregut të punës. BE-ja ka përkrahur zhvillimin e njohurive profesionale përmes disa projekteve që e përshtatin arsimin me nevojat e tregut të punës duke e përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies praktike dhe të aplikuar.

Shkollat e mesme për Arsim dhe Aftësim Profesional (AAP) në Kosovë i ofrojnë dy lloje kryesore të programeve të bazuara në punë - të mësuarit e bazuar në punë në shkollat për AAP që i kanë punëtoritë e tyre dhe praktikën profesionale në ndërmarrje. Ekzistojnë 59 shkolla të përgjithshme për AAP në 26 qytetet kryesore të cilat operojnë nën MASHT. Ato ndahen në shkolla teknike, të përziera, ekonomike, mjekësore, artistike, bujqësore, të turizmit, teologjisë dhe qendra të kompetencës - biznesit, administratës dhe tregtisë. Përshtatja e arsimit me nevojat e tregut të punës e financuar nga BE-ja (ALLED - projekti i Përshtatjes së Arsimit me Tregun e Punës) është i përqendruar në tre sektorë: bujqësi, makineri dhe përpunim të ushqimit.[3]

Nën ALLED, janë zhvilluar katër programe dhe ato janë zhvilluar në tetë shkolla profesionale anekënd Kosovës. Këto programe ishin për bujqësi, përpunimin e ushqimit, mekatronikë dhe operues prodhimi. Edhe mësimdhënësit janë trajnuar për këto programe.

Shkolla e mesme profesionale "Jonuz Zejnullahu" në Viti ishte në mesin e tetë shkollave profesionale të cilave u janë ofruar pajisje laboratorike për të zbatuar programin e zhvilluar rishtas për përpunim të ushqimit i cili është inauguruar në shtator të vitit 2017. Interesimi i nxënësve për këtë program ishte shumë i lartë - ku 59 nxënës kanë aplikuar në rrethin e parë të thirrjes. i i nxënësve për këtë program ishte shumë i lartë - ku 59 nxënës kanë aplikuar për rundin e parë të thirrjes.

3. HTTP://WWW.ALLEDKOSOVO.COM/

Drejtori i shkollës, Nijazi Lutfiu, thotë se ky projekt ishte shumë i suksesshëm dhe se ai e ka ndihmuar shkollën për të përmbushur misionin e saj. Me një kabinet të ri dhe një laborator për analizimin e prodhimeve ushqimore, shkolla tani është duke e zhvilluar përpunimin e mishit, prodhimin e qumështit dhe prodhimeve të frutave dhe kohëve të fundit edhe pastave.

Nijazi Lutfiu e quan një mini-fabrikë, duke shtuar se ky ishte projekti më i madh që është zbatuar në këtë shkollë deri tani. "Nxënësit tonë, tani mund t'i përfundojnë modulet e praktikës profesionale në mënyrën më të mirë të mundshme. Ata mësojnë në praktikë dhe po përgatiten për tregun e punës. Vitia njihet për tregun e saj të agrikulturës dhe këtu i kemi disa shoqëri të cilat janë të përfshira në përpunimin e ushqimit të prodhimeve të miellit. Kjo do të thotë se tregu i Vitisë do të jetë në gjendje që pjesërisht të përthithë nxënësit tanë," theksoi Lutfiu. Ajo beson se Kosova duhet ta shtojë buxhetin e shkollave profesionale, në mënyrë që ato të ushtrojnë të drejtën e tyre për prodhim dhe shitje dhe të jenë në gjendje edhe ta mbështesin veten.

Raporti i KE-së për Kosovën 2016 thekson lidhjen e dobët në mes të shkollave profesionale dhe bizneseve në treg. Rreth 40 për qind e të diplomuarve me diplomë profesionale nuk i kanë shkathtësitë e nevojshme që kërkohen në tregun e punës. Arsimi profesional dhe programet trajnuese janë të koordinuara shumë keq dhe ato nuk i mbështesin strategjitë e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Strategjia Kombëtare për Zhvillim e identifikon shpërputhjen në mes të tregut të punës dhe shkathtësive profesionale si një prej pengesave kyçe për shkallë më të lartë të punësimit. Kjo për shkak se nuk ka sistem i cili do të përcaktonte shkathtësitë e kërkuara në tregun e punës në Kosovë. Shpenzimi publik për shkollat e tilla është shumë i ulët dhe shkollave u mungojnë kapacitetet për punë praktike.

Një rrjet interesant është Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim (RrAPK). RrAPK është një koalicion strategjik i katër organizatave të shoqërisë civile me seli në Kosovë të cilat janë të fokusuara në arsim, punësim dhe politika sociale. RrAPK është një projekt i financuar nga BE-ja i cili synon të përmirësojë punësimin e grupeve të ndjeshme në Kosovë dhe përfshirjen e tyre si në tregun e punës edhe në sektorin arsimor duke marrë pjesë në vendimmarrje, zhvillim dhe monitorim të politikave dhe duke lehtësuar dialogun në mes të institucioneve arsimore dhe trajnuese dhe bizneseve. Më konkretisht, RrAPK synon që të sinkronizojë programet arsimore dhe trajnuese me nevojat e tregut të punës.

Strategjitë e zhvilluara nga RrAPK për të përmbushur synimet e tij përqendrohen në përmirësimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për të marrë pjesë në zhvillimin dhe monitorimin e politikave në nivelin qendror dhe atë lokal. Aktivitetet për ngritje të kapaciteteve përfshijnë programet trajnuese, këshillat e ekspertëve, të mësuarit nga bashkëpunëtorët dhe këmbimi i përvojave.

Projekti i RrAPK zbatohet përmes një koalicioni i cili udhëhiqet nga Qendra për Arsim e Kosovës (QAK) në bashkëpunim me Balkan Sunflowers Kosova (BSFK), Agjencia Kosovare për Promovimin e Punësimit (AKPP), Akademia e Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ATAT) dhe Stichting SPARK.



MBËSHTETJA PËR ARSIMIN E LARTË

PËR ARSIM TË LARTË MË CILËSOR NË KOSOVË

Kosova e ka numrin më të lartë të institucioneve të arsimit të lartë dhe studentëve për kokë banori në Evropë. Aktualisht ekzistojnë 39 institucione të arsimit të lartë të akredituara, nëntë prej të cilave janë publike dhe 30 private. Numri i studentëve është shtuar nga 40.000 në vitin 2004 në 122.000 në vitin 2015/2016. Rritja e shpejtë e numrit të studentëve të regjistruar ka kontribuar edhe në nevojën për të hapur universitete të reja publike.

Përveç Universitetit të Prishtinë janë edhe pesë universitete publike në Prizren, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë dhe Ferizaj. Në vitin 2014, Kosova shpenzonte 703 euro për kokë banori (ose 23,8% të GDP-së për kokë banori) në Arsimin e Lartë. Ndonëse shpenzimi publik është duke u shtuar, shpenzimi për student është duke rënë për shkak të numrit të shtuar të studentëve.

Kosova është duke u përballur me shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë dhe arsimi cilësor është një prej sfidave kryesore që është identifikuar nga punëdhënësit. Diploma universitare nuk garanton doemos punësimin, pasi që 25 për qind e njerëzve me diplomë universitare janë të papunë.

BE-ja ka rekomanduar cilësi më të mirë të arsimit në të gjitha nivelet, funksionim të pavarur të institucioneve të arsimit të lartë; ligj të ri për arsimin e lartë i cili do të përmbushte standardet ndërkombëtare dhe më shumë investime në kapacitetet hulumtuese dhe të inovacionit në nivel kombëtar në mënyrë që të rritet konkurrenca dhe integrimi në Zonën Hulumtuese Evropiane.

Kosova nuk është edhe formalisht anëtare e procesit të Bolonjës, por qëkurse Universiteti i Prishtinës i ka futur Reformat e Bolonjës në vitin 2001/2002 Kosova ka bërë përpjekje që të përshtatë legjislacionin kombëtar dhe të harmonizojë programet studimore në pajtim me udhëzimet e Bolonjës.

Objektivat e Planeve Arsimore Strategjike ë Kosovës e vënë theksin në përmirësimin e cilësisë përmes promovimit të përsosmërisë në mësimdhënie, hulumtime shkencore, inovacion dhe ndërkombëtarizim. Mobiliteti i personelit akademik dhe studentëve po ashtu është një prej objektivave.

Sidoqoftë, arsimi i lartë ende po përballet me mospërputhjen me standardet e cilësisë, programet studimore nuk i reflektojnë nevojat e tregut të punës, dhe nuk ka punë të mjaftueshme studimore. Me fuqizimin e Ligjit të Ri për Arsimin e Lartë, të gjitha institucionet e arsimit të lartë duhet që t'i harmonizojnë statutet dhe rregulloret e tyre ne pajtim me të.

BE-ja e ka ndihmuar arsimin e lartë përmes projekteve të ndryshme. Njëri prej tyre ishte përparimi i arsimit në Kosovë: projekti i ndërkulturalizmit dhe Procesi i Bolonjës në vlerë prej 1,4 milionë eurosh. Projekti e përfshinte mbështetjen për reformat në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë për të përmirësuar vetëdijen dhe mirëkuptimin ndërkulturor dhe për të integruar më tutje Kosovën në Procesin e Bolonjës. Përmirësimi i menaxhimit dhe cilësisë së sistemit të arsimit në përgjithësi është bërë përmes qasjes që mbulon gjithë sektorin në projektin e arsimit me vlerë 3 milion euro. Ky projekt, po ashtu ka çuar te ndërtimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për arsimin së bashku me MASHT-in.

Përmes projektit ALLED prej 3 milionë eurosh (Përputhja e Arsimit me nevojat e Tregut të Punës), BE-ja ka synuar që të fuqizojë cilësinë dhe relevancën e programeve arsimore dhe lidhjes në mes të Arsimit të Lartë dhe nevojave të tregut të punës përmes zhvillimit, modernizimit dhe reformës cilësore të programeve të Arsimit të Lartë. Një tjetër projekt i ngjashëm në vlerë prej 3,8 milionë eurosh do të fokusohet në përmirësimin e cilësisë dhe relevancës së mësimit gjatë gjithë jetës dhe programeve studimore me theks në trajnimet dhe arsimin profesional.

BE-ja, e ka mbështetur është Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM), i cili është një kolegjshumë-etnik i hapur në vitin 2010 nën përkujdesjen e organizatës jo qeveritare holandeze SPARK. BE-ja e ka financuar këtë kolegj me 1,6 milionë euro. Kolegji ishte gati për t'u mbyllur në vitin 2017 për shkak të mungesës së fondeve por BE-ja ka vendosur që të financojë operacionet e IBCM edhe për një vit akademik, 2017-2018. Drejtori i kolegjit, Brian Stains ka deklaruar se mbështetja e BE-së ishte vitale, pasi që mbyllja e IBCM ishte njoftuar në korrik të vitit 2017. Sidoqoftë, për shkak të faktit se fondet janë siguruar vetëm për një vit, Kolegji ishte i detyruar që të ndërpriste regjistrimet. Ndërkohë, Stains shton se IBCM e ka përgatitur një plan biznesi i cili parasheh që të arrijë vetë-qëndrueshmëri deri në vitin 2022.

IBCM do të bëhet një institucion profesional i arsimit të lartë i vetë qëndrueshëm i cili ofron arsim ndërkombëtar të cilësisë së lartë me çmim të arsyeshëm. Përmes ofrimit të arsimit dhe trajnimeve të shkëlqyera, ai do t'u ofrojë të rinjve dhe të rriturve në rajonin e Mitrovicës mundësi ekonomike dhe do të mbështesë zhvillimin ekonomik të rajonit. Përmes aplikimit të motos së IBCM "Nga Teoria në Praktikë" studentët e IBCM pajisen me një sërë shkathtësish të përditësuara, të cilat i ndihmojnë ata që të zhvillojnë karriera profesionale. BE po përkrah arsimin e lartë në Kosovë edhe përmes Skemës së të Rinjve TEMPUS, Programeve ERASMUS MUNDUS dhe Horizont 2020.

TEMPUS ishte programi i BE-së i dizajnuar për të ndihmuar procesin e reformave në arsimin e lartë në Vendet Partnere, modernizimin dhe lehtësimin e të mësuarit të ndërsjellë në mes të rajoneve dhe njerëzve. TEMPUS është prezantuar në Kosovë në vitin 2000 dhe Zyra e Tempus në Kosovë është hapur në vitin 2003. Që atëherë, institucionet arsimore publike dhe private në Kosovë kanë marrë pjesë në 78 projekte të Tempus dhe Erasmus+, të cilat e kanë mundësuar bashkëpunimin institucional me shtetet e BE-së

Kosova ka qenë shtet partnerë i Erasmus+ që nga viti 2015 përmes Zyrës së saj Erasmus+ në Prishtinë, dhe zyrën e saj në Mitrovicën Veriore. Erasmus+ ofron mundësi për individët që të kalojnë jashtë shtetit një periudhë të mobilitetit apo vullnetarizmit dhe për organizatat që të bashkëpunojnë në partneritetet e projekteve në fushat e trajnimeve akademike dhe profesionale, shkollave, të mësuarit për të rritur dhe ngjarjet sportive evropiane. Programi, po ashtu parasheh bashkëpunimin me Shtetet Partnere në fushën e arsimit të lartë dhe të rinisë. Programi i mbështet organizatat, institucionet apo grupet të cilat më pastaj mbështesin një gamë të gjerë të individëve - studentëve, stazhierëve, nxënësve, vullnetarëve, mësimdhënësve, profesorëve, etj.

Sot Kosova mund të përfitojë nga katër komponentë të Erasmus+: Mobiliteti Ndërkombëtar i Krediteve të studentëve dhe personelit akademik; Bursat për Erasmus Mundus Joint Masters; Ndërtimi i Kapaciteteve dhe aktivitetet "Jean Monet" për të promovuar rezultate të shkëlqyera në mësimdhënie dhe hulumtime në fushën e studimeve të BE-së në mbarë botën.

Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë janë shumë aktive në mobilitetin ndërkombëtar të kredive dhe ka shumë interesim të lartë nga të rinjtë që të përfitojnë nga këto mundësi.

Për shembull, Universiteti i Prishtinës ka krijuar partneritet me universitetet në mbarë Evropën, thotë Lumnije Bajrami, Drejtoreshë e Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare në UP.

"Jo vetëm studentët, por edhe personeli akademik mund të marrin pjesë në këtë program. Numri i marrëveshjeve me universitetet partnere është duke u rritur çdo ditë e më shumë, ashtu si edhe numri i pjesëmarrësve. Studentët tanë nga nivelet e ndryshme akademike mund të kalojnë një semestër ose dy jashtë shtetit dhe të fitojnë kredi nga kjo dhe personeli ynë akademik mund të kalojë një javë me ligjërime në universitetet tona partnere. Kjo është një mundësi për të udhëtuar, mësuar, praktikuar gjuhën dhe për një përvojë shumë të mirë," theksoi Bajrami.

Deri tani, 1.341 pjesëmarrës nga Kosova kanë marrë pjesë në Mobilitetin ndërkombëtar të kredive, përderisa 647 pjesëmarrës nga Evropa kanë ardhur në Kosovë.

ERASMUS +

Granit Brajshori, shqiptar nga Kosova

Diploma Bachelor në Shkencat Politike, aktualisht duke i vijuar studimet Master në Integrimet Evropiane dhe Administratë Publike në Universitetin e Prishtinës

NË CILIN PROGRAM KENI MARRË PJESË DHE PSE?

Unë kam marrë pjesë në programin e Erasmus+, si një student i shkëmbyer në Universitetin Vilnius në Lituani, ku i kam ndjekur katër lëndë në fakultete të ndryshme. Një nga lëndët ose kurset e mia ishte në Fakultetin e Drejtësisë, një tjetër kurs që e kam përfunduar ishte në Fakultetin e Ekonomisë, përderisa dy të tjerët ishin në kuadër të kurrikulës së Institutit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Shkencave Politike të Universitetit Vilnius.
Arsyeja pse unë aplikova në këto kurse ishte sepse ato ishin më të përshtatshmet ndonëse nuk ishin tërësisht të ndërlidhura me studimet e mia në universitetin tim.

SI DO TA PËRSHKRUAJE PËRVOJËN TËNDE JASHTË SHTETIT? ÇKA JU KA PËLQYER?

Përvoja ime jashtë shtetit ishte një mundësi shtesë dhe e çmuar për të fituar njohuri të reja dhe për të fituar përvoja të reja. Do ta quaja si një përvojë të mirë përkundër faktit se lëndët në mes të dy universiteteve nuk janë përshtatur. Sidoqoftë, unë e pata rastin që të takoja kultura të reja dhe të punoja dhe studioja në një mjedis shumë kulturor gjë që padyshim e shton kreativitetin por edhe sfidat.

SA E DOBISHME ËSHTË PËR PLANET E TUA TË ARDHSHME PËRVOJA DHE NJOHURITË E FITUARA PAS PËRFUNDIMIT TË PROGRAMIT?

Siç edhe e kam cekur më parë, kjo përvojë është një aset për karrierën time akademike dhe shpresoj se do të më japë një avantazh ne fushat e ndryshme të nismave të mia në lidhje me sfidat dhe krijimit të ndjenjës së të jetuarit dhe ndarjes se ideve dhe pikëpamjeve me njerëz të ndryshëm me prejardhje të ndryshme dhe nga vende të ndryshme.

Edis Galushi, rom i Kosovës nga Prizreni

Diplomë master si mësimdhënës i gjuhës angleze si gjuhë e huaj - të lëshuar nga Universiteti i Zagrebit

NË CILIN PROGRAM KE MARRË PJESË DHE PSE?

Unë kam marrë pjesë në Programin ERASMUS MUNDUS sepse më ka ofruar kushtet më të mira të mundshme dhe mbështetje të paparë, e cila më ka mundësuar që të përparoj si në rrafshin personal ashtu edhe në atë akademik. Unë e kam marrë diplomën time Master në Universitetin e Zagrebit, pasi që kam diplomuar në Universitetin e Prishtinës. Gjatë studimeve bachelor, përmes Erasmus Mundus unë e kam zhvilluar edhe një program të shkëmbimit për një vit akademik në Lituani, në Universitetin Vilnus.

SI DO TA PËRSHKRUAJE PËRVOJËN TËNDE JASHTË SHTETIT? ÇKA JU KA PËLQYER?

Duke pasur parasysh se Kosova është një nga vendet më të izoluara në Evropë, mundësia që të udhëtoja dhe studioja jashtë shtetit pa dyshim më ka zgjeruar horizontin tim dhe më ka ndihmuar që të zgjeroj njohuritë dhe përvojën time profesionale. Ajo që më ka pëlqyer është se më ka bërë që të kuptoj diversitetin social dhe kulturor të Evropës, si dhe më ka bërë që të shoh botën nga një këndvështrim tjetër, gjë që për fat të keq shumica e kosovarëve nuk e kanë mundësinë që të bëjnë.

SA E DOBISHME ËSHTË PËR PLANET E TUA TË ARDHSHME PËRVOJA DHE NJOHURITË E FITUARA PAS PËRFUNDIMIT TË PROGRAMIT?

Duke qenë se jam diplomuar në një Universitet i cili tradicionalisht krijon kuadro të përgatitur mirë dhe profesionale, njohuritë dhe përvoja që i kam fituar, me rastin e përfundimit të programit më ka bërë një garues cilësor në tregun e punës dhe pa dyshim i ka rritur mundësitë e mia për të gjetur një punë të mirë dhe të paguar mirë.

YOUNG CELL SCHEME

Që nga viti 2004, studentët e Kosovës kanë marrë pjesë edhe në Young Cell Scheme, një Program i Bursave Pasuniversitare i BE-së për Kosovën i cili synon që të kontribuojë për një administratë publike efektive dhe efikase në Kosovë në të gjitha nivelet, duke ndërtuar një shërbim civil profesional dhe jo politik nga ata që e fitojnë bursën. Projekti i financuar nga BE-ja, u jep qytetarëve të Kosovës një diplomë Bachelor për të vijuar më tutje studimet në një prej universiteteve të BE-së. Pas përfundimit, ata e kanë një obligim kontraktual që të kthehen në Kosovë dhe të punësohen për së paku tri vjet në administratën publike të Kosovës.

Bursa i mbulon pagesën e shkollës, shpenzimet jetësore, shpenzimet për vizë, sigurimin shëndetësor dhe biletat e avionit. Mbi 250 studentë kanë marrë pjesë në këtë program dhe rreth 80% e tyre punojnë në institucionet qeveritare. Që nga viti 2004, Young Cell Scheme është zgjeruar në komunat në veri të Kosovës me synim që të mbështesin reformën e qeverisë lokale.

Sanja Mrkiq **nga Mitrovica Veriore ishte një nga pjesëmarrësit. Ajo e ka diplomën Master në marrëdhëniet ndërkombëtare nga Instituti i Barcelonës (IBEI) në kuadër të programit të bursave Young Cell Scheme (YCS).**

SI DO TA PËRSHKRUAJE PËRVOJËN TËNDE JASHTË SHTETIT? ÇKA JU KA PËLQYER?

Studimi dhe të jetuarit jashtë shtetit, posaçërisht në një qytet metropolitan si Barcelona, më ka ofruar njohuri për një sistem të ndryshëm arsimor, një kulturë dhe gjuhë të re. Duke qenë se unë e kam përfunduar diplomën time Bachelor në kuadër të një programi të vjetruar arsimor, kjo përvojë më ka ofruar njohuri të dobishme për sisteme më të përparuara arsimore.

SA E DOBISHME ËSHTË PËR PLANET E TUA TË ARDHSHME PËRVOJA DHE NJOHURITË E FITUARA PAS PËRFUNDIMIT TË PROGRAMIT?

Përvoja dhe njohuritë e fituara janë dëshmuar tejet të dobishme për rritjen time profesionale duke pasur parasysh interesimin tim personal në punët ndërkombëtare dhe çështjet gjeopolitike. Për më tepër, kjo përvojë gjithashtu e ka konfirmuar përkushtimin tim që të nxisë anëtarët e komuniteteve pakicë që të shfrytëzojnë këtë mundësi dhe për të përparuar jetën e tyre.

ZYRA E BE NË KOSOVË/PËRFAQËSUESJA E POSAÇME E BE-SË

E SHTYPUR NË KOSOVË, 2018

© ZYRA E BE-SË NË KOSOVË / LEJOHET RIPRODHIMI
NËSE JEPEN INFORMATA PËR BURIMIN

TEKSTI: AMRA ZEJNELI LOXHA, ARBËR SELMANI

DIZAJNI DHE FAQOSJA: SAMIR HALITI

FOTOGRAFITË: SAMIR KARAHODA, DIMITRIOS MACHAIRIDIS

REDAKTORË: FJOLLA ÇEKU SYLEJMANI, DIMITRIOS MACHAIRIDIS, ZYRA E BE-SË NË KOSOVË

NA VIZITONI NË
QENDRAT INFORMATIVE DHE KULTURORE
TË BASHKIMIT EVROPIAN:

PRISHTINË
Rr. "Nënë Tereza" nr. 63
Prishtinë 10000, Kosovë
Telefoni: +381 (0) 38 25 99 99
E-mail: info@euicc-ks.com

MITROVICA VERIORE
Rr. "Kralja Petra I", p.n.
Mitrovicë Veriore 40000, Kosovë
Telefoni: + 381 (0) 649097882
E-mail: mmilosavljevic@euicc-ks.com

European Union Kosovo

EU INFORMATION AND CULTURAL CENTRE

WWW.EUICC-KS.EU